



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, në datën 31 janar 2018, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar
Zylyftar	BREGU	Anëtar

AMA, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Azhornimin e zonës së ofrimit të shërbimit të disa subjekteve të autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor”. **(Vendimi nr. 1, datë 31.01.2018);**
2. “Miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Multiscreen” sh.p.k., zëvendësimin e licencës së subjektit me licencë shërbimi programi audioviziv në qarqet Korçë dhe Berat si dhe rinovimin e licencës për transmetime analoge së subjektit audioviziv privat “Report TV”, në zonat ku vijojnë transmetimet analoge”. **(Vendimi nr. 2 datë 31.01.2018);**
3. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “Vintage Radio” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Vintage Radio” **(Vendimi nr. 3, datë 31.01.2018)**
4. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “4 Plus Media Group” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio 4+”. **(Vendimi nr. 4, datë 31.01.2018)**
5. “Miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Dynamics Sound” sh.p.k., dhe rinovimin e licencës për subjektin audio privat vendor “Radio Eagle”. **(Vendimi nr. 5, datë 31.01.2018);**
6. “Zvogëlimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Focus Media News” sh.p.k., dhe rinovimin e licencës për subjektin audio privat vendor “Radio Rash”. **(Vendimi nr. 6, datë 31.01.2018);**
7. “Rinovimin e licencës së subjektit audio me përsëritës “Radio RFI”. **(Vendimi nr. 7, datë 31.01.2018);**
8. “Rinovimin e licencës së subjektit audio me përsëritës “CRI Radio e Jashtme e Kinës” dhe ndryshimin e karakteristikave teknike të transmetimit”. **(Vendimi nr. 8, datë 31.01.2018);**
9. “Rinovimin e licencës së subjektit audio me përsëritës “Radio BBC” dhe kalimin e të drejtave të përfaqësimit të subjektit tek Radio Televizioni Shqiptar”. **(Vendimi nr. 9, datë 31.01.2018);**
10. “Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “ABcom” sh.p.k., autorizuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “3N1 TV” dhe përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor

“ABCOM”, në njësitë administrative Luz i Vogël, Lekaj Gosë, Maliq, Libonik, Pirg, Pojan, Vreshtas, Gramsh, Pishaj dhe Kodonjat.” **(Vendimi nr. 10, datë 31.01.2018)**

11. “Miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Masa Grup 2009” sh.p.k., dhe rinovimin e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Masa Grup”. **(Vendimi nr. 11, datë 31.01.2018);**
12. “Dhënien e autorizimit, shoqërisë “Itcom” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Itcom”, për të ofruar shërbim në “Njësinë Administrative Shkodër”. **(Vendimi nr. 12, datë 31.01.2018);**
13. “Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Elbasan Tv” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “Elbasan TV”. **(Vendimi nr. 13, datë 31.01.2018)**
14. “Mosrinovimin e licencës së shoqërisë “Channel 1” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Idea”. **(Vendimi nr. 14, datë 31.01.2018);**
15. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të personit fizik Shkëlqim Bylykbashi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Arbër”. **(Vendimi nr. 15, datë 31.01.2018)**
16. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Taulant Kurti, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Shalës” **(Vendimi nr. 16, datë 31.01.2018);**
17. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Edmond Zane, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor M.O.D” **(Vendimi nr. 17, datë 31.01.2018);**
18. “Kalimin e të drejtave të autorizimit të subjektit person fizik Arben Nazëraj, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Manastiri” tek subjekti person fizik Arben Mërtiri, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Arten. **(Vendimi nr. 18, datë 31.01.2018);**
19. “Kalimin e të drejtave të autorizimit të subjektit person fizik Gentian Ferhati, për ofrim shërbimi programi audioviziv online “Tv Wedding Channel” tek shoqëria “Gentian Ferhati” sh.p.k.” **(Vendimi nr. 19, datë 31.01.2018);**
20. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë, Nr. 92, datë 14.12.2017, në masën 120,000 lekë, të vendosur ndaj shoqërisë “Nisatel” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (OTT) “Nisatel” **(Vendimi nr. 20, datë 31.01.2018);**
1. “Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë, nr. 95, datë 19.12.2017, në masën 120,000 lekë, të vendosur ndaj shoqërisë “Bleta” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV) “Bleta”. **(Vendimi nr. 21, datë 31.01.2018);**
2. “Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë, nr. 96, datë 19.12.2017, në masën 120,000 lekë, të vendosur ndaj shoqërisë “TV Kabllor Vlora Cable” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në kabllor “TV Kabllor Vlora Cable”. **(Vendimi nr. 22, datë 31.01.2018);**
3. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë, nr. 91, datë 01.12.2017, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj personit fizik Elion Boriçi, autorizuar për subjektin “Tv me kabëll Brado”. **(Vendimi nr. 23, datë 31.01.2018);**
4. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë, nr. 97, datë 19.12.2017, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj personit fizik

Agron Beqiri, autorizuar për subjektin “Tv me kabëll Amaregi”. **(Vendimi nr. 24, datë 31.01.2018);**

5. “Zbatimin e vendimit nr. 4831 (80-2017-4905) të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë duke vendosur pajisjen me autorizimin të shoqërisë “Cable Net” sh.p.k. për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor, në Qarkun Elbasan, Bashkinë Lezhë dhe Njësinë Administrative Fier” **(Vendimi nr. 25, datë 31.01.2018).**

Në këtë mbledhje, AMA ra dakord të shtyjë për në mbledhjen e radhës, shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Club Muzikor” sh.a., për marrje licence audio private kombëtare “Club FM Radio” .

Tiranë, 31 janar 2018

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE